

Të nderuar anëtarë të Akademisë,
I nderuar Kryeministër i Republikës, z. Mustafa,
Njerëz të botës akademike, të shkencës dhe të artit,
Laureat i parë i Shpërblimit mbështetës 2014, prof. Qendrim Gashi

Jemi tubuar sot në mjediset e Akademisë për ta shpallur çmimin e themeluar nga Kryesia e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, i emërtuar si "*Shpërblimi mbështetës*", që u jepet kandidatëve të moshës së re që kanë arritur rezultate të veçanta në fushën e shkencës dhe të artit. Ky çmim, që ka filluar të jepet nga viti 2014, tashmë është bërë tradicional. Fondi për këtë shpërblim është krijuar nga donacionet dhe vlera e tij është 3.000 euro.

Kandidati i parë që e mori këtë çmim për rezultate të arritura në fushën e shkencës, konkretisht të shkencës së matematikës, ishte prof. Dr. Qendrim Gashi. Donacioni i parë vitin e kaluar na erdhi nga kompania Ing Office, Sh. P. K., Gjilan, me përfaqësuesin inxh. Mejdi Rexhepi në krye.

Në bazë të konkursit publik të shpallur më 30 janar 2015 u paraqitën 11 kandidatë nga fusha të ndryshme të shkencave dhe të arteve. Kryesia në mbledhjen e vet të mbajtur më 25 shkurt 2015 ka caktuar Komisionin vlerësues në përbërje kryetari i Akademisë Hivzi Islami, akademik Feriz Krasniqi dhe akademik Eqrem Basha. Komisioni pasi e shqyrtoi dokumentacionin e kandidatëve të paraqitur dhe në përputhje me kushtet e kërkuara me konkurs, përzgjedhi për laureate të çmimit "*Shpërblimi mbështetës 2015*" dr. Pranvera Ibrahimin, mjekë, hulumtuese në fushën e mjekësisë, specializante në QKUK, në kardiologji, dhe doktorante në Universitetin UMEÅ në Suedi.

Për këtë çmim donacioni këtë vit na vjen nga kompania "Marigona Residence", me përfaqësuesit Erolld Belegu, Rasim Merlaku dhe Valton Bilalli, të cilët janë këtu dhe në emër të Akademisë i përshëndes dhe i falënderoj shumë. Kjo kompani ka dhënë mjete për shpërblimin mbështetës edhe për dy vitet e ardhshme; një falënderim edhe më i madh!

Shpërblimi është një simbolikë e fortë, sepse, përmes tij, kjo themelatë si më e larta e shkencës dhe e artit në Kosovë, ia njeh punën dhe meritat një të reje, pa i mbushur të 30-at, për atë që ka arritur deri më sot në fushën e shkencës. Për shkak të moshës së re (28-vjeçare), vetëkuptohet që kandidatja nuk ka mundur të arrijë rezultate kulmore në shkencë, por objektivi ynë kryesor është që, në saje të punës së deritanishme shkencor e-hulumtuese, ajo të mbështetet dhe të motivohet për punë të mëtutjeshme produktive në shkencë, në rastin konkret në shkencën e mjekësisë. Prandaj çmimi edhe e mban emrin *shpërblimi mbështetës*. Ky shpërblim është një privilegj edhe për Akademinë që iu dha mundësia, në saje të donacionit në fjalë, ta laureojë një kandidate të kësaj moshe me këto cilësi si garanci se do të zhvillohet në një shkencëtare të mirëfilltë.

Raportin vlerësues për punën dhe rezultatet e arritura të dr. Pranvera Ibrahimit në shkencën e mjekësisë, do ta paraqes akademik Feriz Krasniqi, anëtar i komisionit.